

[Data 23.06.2023]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime konsulence per çeshtje mjedisore.

Vlera e Fondit Limit: **4.115.000 (katër milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 11, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e

përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 12.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 11 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence", si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon “ekspertët kryesorë” për realizimin e këtij

shërbimi si më poshtë vijon:

Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesë: listën emërore të ekspertëve kryesorë, kontratën e punës ose marrëveshjen e angazhimit për këtë procedurë të prokurimit, CV-të, dhe diplomat universitare përkatëse si pjesë e ofertës teknike.

Stafi që duhet të disponojë kontraktori duhet të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

- a. **1 (një) Ekspert Kryesor/MenaxherProjekti** – Eksperti kryesor ose menaxheri i projektit ofron udhëzime në hartimin dhe zbatimin e veprimeve specifike për të ndihmuar planin vendor të veprimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit. Bën rishikimin, modifikimin e të gjitha aktiviteteve të planit dhe produktet që lidhen me biodiversitetin në përputhje me dokumentet e planit. Ai mundëson zhvillimin e kushteve të nevojshme për ekspertët e që do të përfshihen në hartimin e planit.
- b. **2 (dy) Ekspertë Mjedisi** – Të cilët do të sigurojnë drejtimin teknik për masat që duhen marrë në lidhje me biodiversitetin në përgjithësi dhe detyra të tjera të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale. Ata do të hartojnë propozime specifike për adresimin e çështjeve të biodiversitetit dhe për treguesit që lidhen me të. Gjithashtu eksperti i mjedisit do të luajë rol në ofrimin e konsulencës dhe mbështetjes për specialistët e tjerë që do të marrin pjesë në hartimin e planit të biodiversitetit, në përputhje të plotë me politikat, procedurat përkatëse, udhëzimet dhe standardet më të mira.
- c. **1 (një) Specialist Zoolog** - Do të gjejë instrumentat për të reduktuar rrezikun e aktiviteteve njerëzore ndaj kafshëve të egra. Do të identifikojë llojet e rrezikuara, do të përgatisë statistikën për to dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e tyre.
- d. **1 (një) specialist/Agronom ose Hortikulturë**- Do të kryejë mbledhjen e të dhënave në të gjitha aspektet e kërkimit duke përfshirë tokën, cilësinë e ushqimit, diversitetin e bimësisë. Harton masa konkrete për të realizuar vlerësimin e biodiversitetit bujqësor, bimëve të kultivuara (medicinale) etj si edhe do të bëjë mbledhjen e të dhënave për kopshtarinë, frutat, perimet, pemtarinë dhe bën vlerësimin e rezultateve duke përfshirë mjedisin e zonës, shëndetin e bimëve, biodiversitetin, habitatet dhe përdorimin e tyre.
- e. **1 (një) Specialist Gjeograf** – Specialisti Gjeograf do të studiojë natyrën, tokën dhe veçoritë e tokës. Do të bëjë mbledhjen e të dhënave gjeografike përmes vëzhgimeve në terren në lidhje me biodiversitetin.
- f. **1 (një) specialist hedhje të dhënash** – Specialisti i hedhjes së të dhënave do të kryejë procesin e inventarizimit të biodiversitetit (hedhjes së të dhënave në kompjuter). Do të kryejë përditësimin e të dhënave të ndryshme që kanë lidhje me habitatet, speciet, zonat e mbrojtura dhe kërcenimet.

Shënim: Kriteri 2.3.2 dhe nënparagrafi e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Dokumentacioni provues, i kërkuar në pikën 2.3.2 (Stafi) duhet të ngarkohet nga OE, si pjesë e ofertes teknike për efekt të vlerësimit me pikë në fazën e dytë atë të paraqitjes së propozimeve teknike dhe ekonomike.

Një ekspert nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe

nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Per përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

Konkretisht:Argumenti per stafin

- **1 (një) Ekspert Kryesor/MenaxherProjekti** – Eksperti kryesor ose menaxheri i projektit ofron udhëzime në hartimin dhe zbatimin e veprimeve specifike për të ndihmuar planin vendor të veprimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit. Bën rishikimin, modifikimin e të gjitha aktiviteteve të planit dhe produktet që lidhen me biodiversitetin në përputhje me dokumentet e planit. Ai mundëson zhvillimin e kushteve të nevojshme për ekspertët e që do të përfshihen në hartimin e planit.
- **2 (dy) Ekspertë Mjedis** – Të cilët do të sigurojnë drejtimin teknik për masat që duhen marrë në lidhje me biodiversitetin në përgjithësi dhe detyra të tjera të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale. Ata do të hartojnë propozime specifike për adresimin e çështjeve të biodiversitetit dhe për treguesit që lidhen me të. Gjithashtu eksperti i mjedisit do të luajë rol në ofrimin e konsulencës dhe mbështetjes për specialistët e tjerë që do të marrin pjesë në hartimin e planit të biodiversitetit, në përputhje të plotë me politikat, procedurat përkatëse, udhëzimet dhe standardet më të mira.
- **1 (një) Specialist Zoolog** - Do të gjejë instrumentat për të reduktuar rrezikun e aktiviteteve njerëzore ndaj kafshëve të egra. Do të identifikojë llojet e rrezikuara, do të përgatisë statistikat për to dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e tyre.
- **1 (një) specialist/Agronom ose Hortikulturë-** I cili do të kryejë mbledhjen e të dhënave në të gjitha aspektet e kërkimit duke përfshirë tokën, cilësinë e ushqimit, diversitetin e bimësisë. Harton masa konkrete

për të realizuar vlerësimin e biodiversitetit bujqësor, bimëve të kultivuara (medicinale) etj si edhe do të bëjë mbledhjen e të dhënave për kopshtarinë, frutat, perimet, pemtarinë dhe bën vlerësimin e rezultateve duke përfshirë mjedisin e zonës, shëndetin e bimëve, biodiversitetin, habitatet dhe përdorimin e tyre.

- **1 (një) Specialist Gjeograf** – Specialisti Gjeograf studion natyrën, tokën dhe veçoritë e tokës. Bën mbledhjen e të dhënave gjeografike përmes vëzhgimeve në terren në lidhje me biodiversitetin.
- **1 (një) specialist hedhje të dhënash** – Specialisti i hedhjes së të dhënave do të kryej procesin e inventarizimit të biodiversitetit (hedhjes së të dhënave në kompjuter). Do të kryej përditësimin e të dhënave të ndryshme që kanë lidhje me habitatet, speciet, zonat e mbrojtura dhe kërcënimet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

*Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit.

Objekti i përgjithshëm i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, duhet të jetë integrimi për mbrojtjen dhe ruajtjen e tij, në proceset e menaxhimit të qëndrueshëm dhe planifikimit brenda sektorëve të ndryshëm të qytetit, si dhe projektet strategjike.

Objektivat specifikë të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit do të jenë:

- ◆ Përputhja me dokumentin e politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, duke kontribuar në zbatimin e politikave të ruajtjes dhe mbrojtjes se tij.
- ◆ Krijimi i mundësive për të zvogëluar humbjen e biodiversitetit dhe për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjet që mund ta përmirësojnë dhe shtojnë atë.
- ◆ Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe rekreative.
- ◆ Zgjerimi dhe përmirësimi i korridoreve të gjelbra natyrore.
- ◆ Pakësimi i impakteve negative që ndikojnë në gjendjen e ekosistemeve, habitateve, dhe biodiversitetit në tërësi.
- ◆ Në përputhje me SDG-s 15 ku kërkohet mbrojtja , rikualifikimi, promovimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, parandalimi i degradimit të tokës dhe humbjes së biodiversitetit.
- ◆ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë të popullsisë lokale në lidhje me ndërgjegjësimin për biodiversitetin dhe rëndësinë e tij.
- ◆ Menaxhimi i punës për hartimin e planit.

Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

Hartimi i PVVMRB ka si qëllim integrimin e të gjitha elementëve kryesorë të diversitetit biologjik, si ruajtja e

habitateve natyrore, florës dhe faunës në planet dhe vendimmarrjet në nivel lokal duke rregulluar përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, për të siguruar mundësi sociale, ekonomike dhe kulturore, shëndetsore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm. Ky plan do të hartohet për mbrojtjen e biodiversitetit që është pjesë e Bashkisë Tiranë dhe natyrisht në koordinim edhe me njësitë e tjera fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, dhe të sigurojë një ndërveprim me aktorët dhe Bashkinë si dhe koordinim me institucionet qëndrore.

Sa më sipër hartimi i kërkesave për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike/ termat e referencës dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së si dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **”Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen Biodiversitetit”** Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit;

Termtat e Referencës

